



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

NJOFTIM
PËR MBLEDHJE PLENARE
16 JANAR 2025

Informacion mbi mbledhjen:

Dita/Data:	E enjte, 16.01.2025
Ora:	10:00
Kohëzgjatja:	~ 60 min
Thirrur nga:	Kryetari i Këshillit
Pjesëmarrësit:	Anëtarët
Kuorumi i nevojshëm:	7 Anëtarë

Kjo mbledhje do të organizohet në sallën e mbledhjeve të Këshillit, në prezencë të Anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe të ftuar përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, Prokurori i Përgjithshëm dhe Programet EU4JUSTICE dhe OPDAT. Media si gjithmonë është e ftuar të jetë e pranishme.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të Seancës Plenare të datës 10.12.2024;
2. Diskutim/ miratim i projektaktit mbi “*paraqitjen e konkluzioneve përfundimtare nga palët në procedimin disiplinor nr. 2292/6, datë 13.12.2024 ndaj magjistratit ******”;
3. Diskutim/ miratim i projektaktit për “*Caktimin e përkohshëm të prokurores Elidjana Kasa si prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë*”.
4. Diskutim/ miratim i projektaktit për “*Caktimin e përkohshëm të prokurores Pranvera Pustina në Prokurorinë e Përgjithshme*”;
5. Diskutim/ miratim i projektaktit për “*Mbylljen e procedurës së ngritjes në detyrë për pozicionin e drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat*”;
6. Diskutim/ miratim i projektaktit për “*Mbylljen e procedurës së ngritjes në detyrë për pozicionin e drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës*”;
7. Zgjedhja e zëvendëskryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Të tjera (pyetje/diskutime)

- Mbi përcaktimin e numrit të kandidatëve për magjistrat, të profilit prokuror në programin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2025-2026.
- Kërkesa e Shkollës së Magjistraturës për komandimin e një prokurori si pedagog i brendshëm;

Spektori i TIK, Digjitalizimit dhe Statistikës bën publikimin e kësaj axhende në faqen web të Këshillit.

Ftohen të gjithë anëtarët e Këshillit për të marrë pjesë.

Kryetare

Mirela Bogdani